



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Komuna Rahovec - Opštine Orahovac**  
**Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë**  
**Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu**

Datë/a	03.04. 2020
Referencë/a	
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i K. Rahovec
CC:	Z. Fatmir Iska Nënkyetar i K. Rahovec
Përmes/Prekp/Through:	Drejtperdrejt
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi Jurist i Dipl. Drejt i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti tre mujor i punës Janar-Mars 2020



Raporti tre mujor i punës i vitit 2020

**Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2020 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2020.

Gjatë periudhës tre mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	210	4,120 €
Gjeodezi	1127	3,510 €
Referenti	1,340+38 L.Z.	4,840 €
<b>Totali</b>	<b>2,677+38 L.Z.</b>	<b>12,470 €</b>

Gjatë muajit Janar i kemi përfunduar këto punë:

Kemi përgatitur material të nevojshëm për mbledhjen e Kuvendit Komunal i cili është mbajtur me datën 26 Janar 2020 në të cilën kemi shpallur interes të përgjithshëm në Z.K. Rahovec dhe në Z.K. Xërxë për hapje të rrugës publike.

Me kërkesë zyrtare të inspektoratit kemi dalë në teren dhe kemi inqizur gjendjen në Z.K. Cifllak me të cilën është konstatuar uzurpim të pronës publike, janë nxjerr vendimet dhe është kërkuar nga uzurpatori që ta lirojë pronën publike.

Me kërkesë të drejtoris për Ekonomi kemi nxjer historiatin e parcelës për Zonën Ekonomike dhe e njejtja i është dërguar ministris përkatëse për kompletimin e lëndës.

Avokati i komunës me kërkesë zyrtare ka aplikuar për ekzekutimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në lidhje me këmbimin e pronës ndermjet Komunës së Rahovecit dhe Agjensionit pyjor të Kosovës në sipëraqe prej 60 ari në Z.K. Apterushë për ndertimin e Kullës së Gurit në vend rrënjën e Herojve të Kosovës "Toni e Mici" me bashkëluftëtar.

Eshtë mbajtur trajnimi i punëtorve nga AKK në Prishtinë në lidhje me pranimin e lëndëve nga drejtoria e Urbanizmit në lidhje me legalizimin e objekteve pa leje dhe rregjistrimi i tyre në librat kadastral, ky proces ka përfunduar dhe tashmë lëndë po pranohen dhe po regjistrohen.

Pergjigje me shkrim në lidhje me kërkesat e avokatit të Komunës në lidhje me lënde që janë në proces në gjykata.

Gjatë muajit Shkurt i kemi përfunduar këto punë:

Me kërkesë zyrtare të drejtoris së bujqësis kemi përfunduar nxjerrjen e koordinatave për rrugë fushore për disa Zona Kadastrale në nivel Komune.

Takim me planer në drejtori të Urbanizmit në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me drejtorin tonë në lidhje me materialin që lidhet me projektimin e Sheshit Qëndror te Qytetit.

Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi dalë në teren në lidhje me vërtetimin e pretendimeve për uzurpim të pronës publike në tre zona kadastrale në Apterushë, Brestoc dhe në Krushë të Madhe.

Takim pune në lidhje me harmonizimin e Rregullorës Komunale dhe Udhëzimeve Administrative të AKK-së që lidhen direkt me shërbime- produkte që ofron drejtoria jonë.

Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së palve në lidhje me faljen e pronës private për hapje të rrugës dhe përkthimi në pronë publike në Z.K. Rahovec.

Trajnimi dhe rilicencimi i punëtorve nga AKK-ja në lidhje me ofrimin e shërbimeve edhe në dy zona kadastrale në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe në kohën e aplikimeve për subvencione bujqësore.

Nxjerja e aktvendimeve për uzurpim të pronës publike.

Gjatë muajit Shkurt i kemi përfunduar këto punë:

Me kërkesë zyrtare të Këshillit të fshatit Malsi e Vogël kemi dalë në teren kemi kufizur parcelen e cila po destinohet për interes të përgjithshëm publik për nevojat e fshatit.

Inqizimi i rrugës publike nga rrethi në hyrje te qytetit në drejtim të rrugës tranzite Rahovec-Malishevë në anën e djathtë të rrugës ku është planifikuar të zgjerohet edhe me një shirit, dhe inqizimi i rrugës Rahovec-Xërxë të dy anë të rrugës sipas projektit të rrugës për katër korsi ku sipas inqizimit ka rezultuar me uzurpim të pronës publike në zonën kadastarle në Bërnjak dhe në Fortesë.

Me kërkesë zyrtare të drejtorisë së arsimit kemi përfunduar dokumentacionin e kërkuar për 7 zona kadastarle në lidhje me situacionin e terrenit, certifikatat e pronës dhe kopje plani për shkolla dhe qerdhet publike.

Përgjigje në kërkesat e parashtruara nga Avokati i Komunës.

Dhe punë tjera sipas kërkesave të palëve.

Me respekt,

Afrim Oruqi

*Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë*

**Komuna Rahovec**

Mob: +377 (0) 45 134 006

Ctx: +381 (0) 3820045311

[afrim.oruqi@rks-gov.net](mailto:afrim.oruqi@rks-gov.net)

